

**VENDIM**  
**"Ne Emer te Republikes"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore e perbere prej:

**Mirela MISHGJONI - GJYQTARE**

Asistuar nga sekretare e seances Marjanela Stefi, ne Vlore, me date 18.09.2013, ora 11.00, ne seance gjyqesore me dyer te hapura, mori ne shqyrtim kerkesen penale nr.277, date 28.05.2013 qe i perket:

**KERKUES:**

Shoqeria "~~.....~~", me seli ne Vlore, lagje "~~.....~~"  
Kati i trete, ne mungese.

**OBJEKTI:**

Shfuqizim i vendimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore "Per sekuestrimin e sendeve (njesi kompjuterike)", date 15.05.2013.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 208, 212 i Kodit Procedures Penale.

**ME PJESEMARRJEN:**

Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore, e perfaqesuar nga Prokurore "~~.....~~"

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e njoftimit te kerkuesit Shoqeria "~~.....~~" degjoi Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Vlore qe kerkoi pushimin e gjykimit.

**VEREN**

Kerkuesi Shoqeria "~~.....~~", me kerkesen objekt gjykimi, ka kerkuar shfuqizimin e vendimit date 15.05.2013 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore "Per sekuestrimin e sendeve (njesi kompjuterike)".

Rezultoi se ne seancen gjyqesore te dates 18.09.2013 nuk u paraqit kerkuesi Shoqeria "~~.....~~", pavaresisht se kish dijeni rregullisht per daten dhe oren e gjykimit nepermjet njoftimit me shpallje date 19.07.2013. Nga verifikimi i kryer ne

sekretarine e gjykates nuk rezultoi qe perfaqcsuesi i kerkuesit te kete paraqitur ndonje shkak per te justifikuar mosparaqitjen.

Neni 348 i Kodit te Procedures Penale parashikon: "Para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor, kryetari kontrollon paraqitjen e palëve...".

Neni 350 i Kodit te Procedures Penale parashikon: "1. Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim i dëmtuari akuzues, nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia, gjykata, edhe kryesisht, shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhron që të përsëritet thirrja....".

Neni 59/3 i Kodit te Procedures Penale parashikon: "Nese i demtuari akuzues ose mbrojtési i caktuar prej tij nuk paraqiten ne seance pa shkaqe te arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit".

Ne rrethana te tilla, gjykata emon se mosparaqitja e kerkuesit Shoqeria [redacted], pa shkaqe te arsyeshme tregon mungesen e interesit te tij per zhvillimin e gjykimit. Ne rrethanat kur gjykata eshte vene ne levizje me kerkese te kerkuesit dhe ne kushtet kur kerkuesi, pa shkaqe te perligjura, nuk paraqitet ne gjykim, gjykata arrin ne konkluzionin se ky gjykim nuk mund te vazhdoje ne mungese te tij dhe per kete shkak do te vendose pushimin e gjykimit te kerkeses penale objekt gjykimi.

### PER KETO ARSYE

Gjykata, ne baze te neneve 112, 212 te Kodit te Procedures Penale

### VENDOSI


- Pushimin e gjykimit te kerkeses penale nr.277, date 28.05.2013, qe i perket: Kerkues: [redacted]. Objekti: Shfuqizim i vendimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore "Per sekuestrimin e sendeve (njese kompjuterike)", date 15.05.2013.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit.
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes, afat qe per kerkuesin ne mungese fillon nga e nesermja e komunikimit.

Vlore me 18.09.2013

SEKRETARE  
Marjanela STEFI



GJYQTARE  
Mirela MISHGJONI



VENDIMI MORI FORME TE PRERE  
PASI NUK U ANKIMUA  
me date 14.10.2013  
K/SEKRETARE  
REZARTA TAUSHANI



14.10.2013

Tasurore  
Ismail D. D. D.  
